



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 25 nëntor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_863\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 16 paragrafin 5 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V-568-2013 të datës 24 Tetor 2013 për shoqërinë "Kelkos-Energy" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Lumëbardhi II., me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, njësia gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumit Deçan, komunën e Deçanit;
- Vendimin V-763-2016 të datës 28 janar 2016 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit për Autorizim Final V-568-2013 të datës 24 tetor 2013 lëshuar shoqërisë "Kelkos-Energy" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Lumëbardhi II., me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, njësia gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumit Deçan, komunën e Deçanit
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të vendimit për Autorizim V\_568\_2013 i vazhduar me vendimin V-763-2016 edhe për një (1) vit, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Lumëbardhi II., me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, njësia gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumit Deçan, në komunën e Deçanit, të datë 20.10.2016 të shoqërisë "Kelkos-Energy" sh.p.k., me adresë rruga "Sali Ceku" ndërtesa Gogaj,51000, nr. 14, Deçan, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 25 nëntor 2016 nxori këtë:

**V E N D I M**

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_568\_2013 i datës 24 tetor 2013, i shoqërisë "Kelkos-Energy" sh.p.k., i vazhduar me vendimin V-763-2016 i datës 28 janar 2016 për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Lumëbardhi II., me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, njësia gjeneruese që do të vendosen në lokacionin e lumit Deçan, në komunën e Deçanit, edhe për dymbëdhjetë (12) muaj, gjegjësisht deri me **24 tetor 2017 për përfundimin e ndërtimit.**

**A r s y e t i m**



- ZRRE me datë 09.08.2010 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 23.1 MW, në lokacionet: Lumëbardhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, HC Belaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, të gjitha në Komunën e Deçanit.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_296\_2010 me datë 11 nëntor 2010. Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 09.11.2012 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V- 296-2010 të datës 11 nëntor 2010, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, për mundësin e kompletimit të aplikacionit.
- ZRRE me datë 30 nëntor 2012 ka vendosur me vendimin V-402-2012 që shoqërisë “ Kelkos \_ Energy” sh.p.k., ti shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-296-2010 i datës 11 nëntor 2010 edhe për një afat gjashtë(6) mujor, gjegjësisht deri me 11 maj 2013.
- ZRRE me datë 28.05.2013 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar njoftimin se procesi në lidhje me HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, i shoqërisë “ Kelkos –Energy” sh.p.k., është në fazën e fundit, ku MMPH së fundmi ka lëshuar Lejen Urbanistike dhe shpejti do të lëshohet edhe Leja e Ndërtimit, e cila do të kompletton procedurën për marrjen e Autorizimit në ZRRE.
- ZRRE me datë 27.09.2013 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 24.10.2013 ka vendosur që shoqërisë “Kelkos-Energy” sh.p.k., ti lëshohet Autorizimi V\_568\_2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, njësia gjeneruese që do të vendoset në lokacionin e lumit Deçan të Komunën e Deçanit.



- ZRRE me datë 21.10.2015 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_568\_2013 të datës 24 tetor 2013, për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, **për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit.**
- ZRRE me datë 28 janar 2016 ka vendosur me vendimin V-763-2016 që shoqërisë “ Kelkos \_ Energy” sh.p.k., ti shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Finalr V-568-2013 i datës 24 tetor 2013 edhe për një afatë një (1) vjeçar, gjegjësisht deri me **24 tetor 2016.**
- ZRRE me datë 20.10.2016 nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_568\_2013 të datës 24 tetor 2013, i vazhduar me vendimin V-763-2016 të datës 28 janar 2016 për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, për një afat shtesë **për zgjatjen e periudhës së caktuar për përfundimin e ndërtimit edhe për një (1) vit.**
- Shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., në kërkesën e saj ka sqaruar se: gjatë 18 muajve të fundit, ka kryer matje të gjera gjeologjike dhe hidrologjike në vendndodhjen e digës së HC Lumëbardhi II dhe ka bërë përgatitje të shtratit të rezervuarit nëpërmjet gërmimeve të ujit materialit kryesor zhavorr( matjet hidrologjike janë vonuar disa muaj pas të dhënat e vlefshme nuk mund të mblidhen për një periudhë relevante kohore), dhe rezultatet janë si në vijim: a) Ndryshe nga ajo që pritej, nëntoka në vendin e digave nuk përbëhet nga shkëbinjë në një thellësi 50-80 m, por mbetet materiali zhavorr përtej thellësisë prej 150 m sipas vlerësimeve; b) Matjet e rrjedhës së ujit kanë konfirmuar se në buzë të rrafshnaltës më shumë se 50% e balotazhit të ujit nga rrafshnalta Zali Rupe kalon përmes rrymës nëntokësore përmes këtij materiali zhavorr.
- Rezultatet e matjeve kanë kërkuar ndryshime të nevojshme të projektimit të kombinuar **vepra e marrjes/ diga/ rezervuari**. Projekti i tillë i ndarë i veprës së marrjes –rezervuarit është projektuar për të mbuluar rrjedhjen e plotë të ujit në buzë rrafshnaltë. **Penda Tiroi është zhvendosur në një distancë të shkurtër poshtë lumit në një masë të tillë, siç ishte hidrologjikisht e nevojshme.** Të gjitha këto ndryshimi ishin të koordinuara me MMPH-së, dhe mund të zbatohen në kuadër të kontratave ekzistuese të servitutit.
- Me datë 16 maj 2016 është mbajtur një takim me Sekretarin Permanent të MMPH-së, dhe Drejtorin e Departamentit për Ndërtimi të MMPH-së, ku janë prezantuar dhe diskutuar detajet e ndryshimeve të projektimit. Kjo është konfirmuar nga MMPH-së, se këto ndryshime nuk do të revokojnë lejet ekzistuese dhe do të zbatohet në dokumentacionin ekzistues të lejes së MMPH-së, sipas procedurave, ku pas kërkesës së shoqërisë Kelkos Energy sh.p.k., MMPH-së, ka konfirmuar këtë, me datë 03 qershor 2016. Bazuar në këtë konfirmim të MMPH-së, detajet e punimeve për sistemin e veprës së marrjes, gypave dhe centralit elektrik ka filluar punimet në korrik të vitit 2016, punimet e digave dhe të bazamenteve të rezervuarit janë duke vazhduar.
- Gjithashtu për vonesë prej më shumë se katër (4) muaj kanë ndodhur për shkak të faktit se kompania e kontraktuar për prodhimin e gypave, kishte anuluar shpërndarjen e tyre për shkak të mungesës së furnizimit me material të papërpunuar, prandaj prodhimi i gypave duhet të ritenderohet nga shoqëria KelKos Energy sh.p.k.





- *Shoqëria KelKos Energy sh.p.k., në kërkesën e saj, gjithashtu ka arsyetuar se punimet do të vazhdojnë në periudhën e dimrit 2016 për sa kohë që kushtet e motit të lejojnë, turbinat dhe gjeneratorët duhet të dorëzohen në pranverën e vitit 2017, dhe përfundimi i punimeve dhe fillimi i testimit pritet të realizohet në fund të verës 2017, në varësi të kohëzgjatjes së ndërprerjes së punimeve, të shkaktuara nga kushtet e dimrit. Andaj, bazuar në këtë shoqëria në fjalë, me arsyetimin e dhënë më lartë ka kërkuar që të shtyhet **afati prej një (1) viti për përfundimin e ndërtimit.***
  - *ZRRE me datë 14 nëntor 2016 përmes shkresës zyrtare ka pranuar konfirmimin nga MMPH se Leja Ndërtimore Nr. ZSP 732/13 e datës 09.08.2013 është ende në fuqi, ndërsa s ai përket çështjes së revidimit të projektit MMPH-ja ka qenë e informuar gjatë verës së këtij viti (muajin qershor) se mund të ketë plotësim dhe ndryshim të projektit, por zyrtarisht ende nuk ka pranuar ndonjë kërkesës për aplikim nga ana e Investitorit.*
  - *ZRRE pas analizimit të kërkesës për shtyerje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, edhe për një afat shtesë ligjor, të shoqërisë “Kelkos-Energy” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lumëbardhi i Deçanit: për HC Lumbarëdhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, në Komunën e Deçanit” ka vlerësuar atë, dhe ka konsideruar se për shkak të kompleksitetit të ndërtimit të këtij hidrocentrali të lejohet zgjatje e periudhës për ndërtim, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.*
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V\_568\_2013 i datës 24 tetor 2013, i vazhduar me vendimin V-763-2016 të datës 28 janar 2016 do të shfuqizohet me datë **24 tetor 2017**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

  
Krenar Bujupi, U.D. kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Deçanit
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së